



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR I/5 KËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prarënie / Prifatu Received / Delivered	07.04	2	viti god year
Organ / Shkëmbim Organi / Jednitsa Org / Unit	No Prot Pr Prot No	Shtypje / Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	1959/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.201/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.201/2022 të datës 03.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.201/2022 e datës 03.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi vendimi i datës 02.02.2022 me numër protokollit 159 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë.

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 23.11.2021-30.11.2021 për pozitën “Zyrtar për Media-informim” me nr. reference RN00007825 në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili i është nënshtruar procedurave të konkurrimit. Drejtori i Departamentit për Politikën e Personelit, me datë 21.01.2022 ka shpallur njoftimin për kandidatin fitues të rekomanduar nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 21.01.2022, me datë 27.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë. Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë me vendimin e datës 02.02.2022 me numër protokollit 159 refuzon si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Kundër vendimit të datës 02.02.2022 me numër protokolli 159 ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 03.03.2022 me numër të protokollit 1135/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa me datë 17.03.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 03.03.2022 me numër protokolli 1135/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 17.03.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 1433/2022 bashkë me shkresat e lëndës;Kopja e konkursit e datës 23.11.2021-30.11.2021; Kërkesa e datës 20.10.2021 me nr.2455 për iniciimin e procedurës për hapjen e konkursit; Lista e aplikantëve ; Formulari për verifikimin paraprak të kandidatëve; Vendim i datës 06.12.2021; Lista e kandidatëve të aprovuar; E-mail zyrtar i datës 07.12.2021 -njoftim i verifikimit paraprak të aplikacioneve për pozitën Zyrtar për Media-Informim; Vendimi i datës 16.12.2021 për verifikimin përfundimtar të aplikacioneve; E-mail zyrtar i datës 11.01.2022 , njoftim për intervistim; Orari për intervistim i datës 14.01.2022; Formularët për përmbledhjen e pikëve në intervistën me gojë; Raporti i Komisionit vlerësues për pozitën e zyrtarit të informimit i datës 17.01.2022; Njoftimi i datës 21.01.2022 përmes😊 e-mailit zyrtar për kandidatin fitues; Njoftim i datës 21.01.2022 me nr. reference RN00007825për kandidatin fitues; Njoftimi i datës 02.02.2022 për kandidatin fitues nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Ankesa e datës 27.01.2022 nga ankuesi për Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; E-mail zyrtar i datës 02.02.2022 Vendimi i datës 02.02.2022 me nr.155 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Vendimi i datës 06.12.2021 me nr.685/2021 për emërimin e Komisionin të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Aplikacioni datës 24.11.2021 për Dafina Myrtaj Gashi; Diploma e datës 12.05.2008 nr.152 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës; Vërtetim i datës 12.11.2021 që dëshmon se znj. [emri] është në semestri e IV master në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikata e notave 12.11.2021; Diplomë e datës 22.06.2005 e lëshuar nga Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë-Universiteti AAB; Vërtetim i datës 07.02.2012 për themelimin e marrëdhënies së punës në gazetën Express nga 01.03.2007 deri më datë 30.05.2010; Aktemërimi i datës 31.01.2013 -Zyrtare e lartë për Media/MPB; Vendimi i datës 23.08.2021 për transferim në Ministrinë e Mbrojtjes në pozitë Zyrtare për Media; Vendimi për transferimin e nëpunësve civil i datës 27.07.2021; Vërtetim i datës 17.08.2012 me të cilën dëshmohet se znj. [emri] Zyrtare e lartë për Media prej datës 23.03.2011 deri më datë 30.03.2012 ka qenë u.d.Drejtor i zyrës për Informim Publik;Çertifikatë e datës 12.06.2013;Çertifikatë e dates 05.11.2013; Çertifikatë e datës 28.10.2019; Çertifikatë e datës 18.10.2020; Çertifikatë e datës 12.12.2017 ; Çertifikatë e datës 30.06.2011; Çertifikatë e datës 31.10.2021; Çertifikatë e datës 07.03.2017; Çertifikatë e muajit tetor 2018; Mirënjohje e vitit 2006; Falënderim nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 26.09.2008; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Vërtetim i dates 17.11.2021; Kopja e letërnjoftimit; Aplikacioni i datës 30.11.2021; Pasqyrë e notave e dates 18.03.2019 Kolegji AAB; Diploma digjitale e dates 21.06.2019; Çertifikatë e datës 21.05.2019; Çertifikatë e muajit tetor 2018;

Çertifikatë e muajit shtator 2017; Çertifikatë e 19.07.2019; Vendimi i dates 01.02.2018 i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritit Europian; Vendimi i dates 14.05.2019 i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritit Europian; kopja e letërnjoftimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Plani individual vjetor i punës; Plani individual i trajnimit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Vërtetim I dates 30/11.2021; Letër rekomandimi për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Mbrojtjes me datë 23.11.2021 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për media-informim" bazuar në dispozitat e nenit 38 paragrafi 1,2,3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference RN00007825 i shpallur me datë 23.11.2021, për pozitën Zyrtar për media-informim në Ministrinë e Mbrojtjes, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në Gazetari dhe/apo shkenca shoqërore me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me te,*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy(2) vite përvojë pune në fushën e mediave apo marrëdhënieve me publikun.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar tre (3) kandidatë, që të tretë i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe janë ranguar në listën e ngushtë, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me datë 30.11.2021 me numër reference RAN0001697 i cili ka marrë pjesë në intervistën me gojë, por nuk është përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë sepse i ka pasur 72.6 pikë ndërsa kandidatja fituese renditet e para me 90.4 pikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit të datës 23.11.2021-30.11.2021 për pozitën Zyrtar për media-informim me nr. reference RN00007825 në Ministrinë e Mbrojtjes, sepse i ka mbi 13 vite përvojë pune në fushën e informimit dhe komunikimit dhe gjatë intervistimit konsideroj se jam përgjigjë në mënyrë profesionale, andaj rangimi im i dyti me radhë konsideroj se është i padrejtë. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i pabazuar sepse kandidatja fituese e cila është ranguar e para me 90.4 pikë i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të konkursit. Kandidatja e përzgjedhur znj _____ posedon Diplomën e datës 12.05.2008 me nr.152 të lëshuar nga Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës dhe mori titullin Bachelor i Pikturës me 180 pikë-ECTS, vërtetimin e datës 12.11.2021 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilin vërtetohet se Gashi është në semestrin e IV Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale në Fakultetin e

Edukimit, e njëjta posedon Diplomën e Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë e lëshuar nga Universiteti AAB në Prishtinë e cila diplomoi me datën 22.06.2005 dhe mori titullin Bachelor i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë dhe me këtë përvojë pune: në Gazetën Express nga marsi i vitit 2007 gjer më 30 maj 2010-gazetare në rubrikën nacionale, Akt emërimi i datës 01.02.2013 Zyrtare për Informim Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, znj. me vendimin e datës 27.07.2021 me nr.683 transferohet përkohësisht nga pozita zyrtare e lartë për media në Divizionin për Komunikim me Publikun në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën Zyrtare për media në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Mbrojtjes , vërtetimi i datës 17.03.2012 me të cilin vërtetohet se ka qenë u.d e Drejtorit të Zyrës për Informim me Publikun.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë me rastin e përzgjedhjes së kandidatit fitues ka vepruar drejtë duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 47 paragrafi 2, ku përcaktohet se "2. Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi," dhe nenit 49 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës sepse kandidatja fituese i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuara në konkursin e datës 23.11.2021-30.11.2021 për pozitën Zyrtar për Media- Informim dhe se ankuesi nuk ka precizuar fare se në bazë të cilave dispozita ligjore apo rregullore ka pasur shkelje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave po ashtu ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit se kandidatja e përzgjedhur në pozitën Zyrtare për Media-Informim është pjesë e Zyrës për Informim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe kur ka dalë nga intervista ka qenë e shoqëruar me një zyrtare që kanë shfaqur gjeste afërsie, Kolegji konstatoi se edhe ky pretendim i ankuesit është jo i qartë i pa specifikuar dhe mbi këtë bazë edhe i paqëndrueshëm sepse ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë argument që vërteton një fakt të tillë e që mund të lidhet me procesin e këtij intervistimi.

Kolegji duke marrë në konsideratë edhe pretendimet tjera të ankuesit ,duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe rrethanave të konfirmuara nga përmbajtja e ankesës vërtetohet fakti se i njëjti nuk ka marrë pikët e mjaftueshme mbi bazë të arsyeve të ndryshme sipas pretendimit të tij por që për kolegjin nuk ishin relevante këto pretendime për faktin se nuk ndikojnë në vendimmarrje sa i përket objektit të kësaj ankese për arsyet e specifikuar më lart mbi këtë bazë vendimi i datës 02.02.2022 me numër protokolli 159 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë është nxjerrë në harmoni me legjislacionin në fuqi të Shërbimit Civil.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit e datës 23.11.2021-30.11.2021 për pozitën "Zyrtar për Media-Informim" me nr. reference RN00007825 është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 38 paragrafi 1,2 ,3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 dhe 47 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të



Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.201/2022, datë 07.04.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes;
- ❖ Drejtorit të Departamentit për Politikat e Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

